




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL



KGJK.nr.482/2022
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 300-të, të mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për transfer të znj. Vjosa Desku, bashkëpunëtore profesionale që të transferohet nga Gjykata Themelore Ferizaj dega Kaçanik në Gjykatën Themelore Pejë dega Klinë.
- II. Znj. Desku, si bashkëpunëtore profesionale do të filloj punën në Gjykatën Themelore Pejë dega Klinë, nga data 1 janar 2023.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 14 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga znj. Vjosa Desku, bashkëpunëtore profesionale në Gjykatën Themelore Ferizaj dega Kaçanik, ka pranuar kërkesë për transfer në Gjykatën Themelore Pejë dega Klinë. Sa i përket arsyeve për të cilat ka kërkuar transferin, e njëjta ka theksuar çështjen e largësisë së vendbanimit të saj nga gjykata ku aktualisht ushtron funksionin e bashkëpunëtore profesionale.

Këshilli pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së znj. Desku dhe pëlqimit të dhënë nga kryetarët e gjykatave përkatëse, ka aprovuar transferin nga Gjykata Themelore Ferizaj dega Kaçanik në Gjykatën Themelore Pejë dega Klinë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Vjosa Desku;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Ferizaj;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Pejë;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.

